



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim-Vendosje Kondicioner për Njësitë shpenzuese të  
Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Instalime  
kondicionerësh- 45331220-4, Furnizime-39200000-4

**VLERA E FONDIT LIMIT: FONDI LIMIT TOTAL : 1,506,187.34** (një milion e pesëqind e  
gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë pik tridhjetë e katër) **lekë pa TVSH**

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike vlera e fondit limit është 794,150 (**shtatëqind e  
nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë**) **lekë pa t.v.sh**

Për Rektoratin e Universitetit të Mjekësisë vlera e fondit limit është 712,037.34 (**shtatëqind e  
dymbëdhjetë mijë e tridhjetë e shtatë pikë tridhjetë e katër**) **lekë pa t.v.sh**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mesipercituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk duhet të jetë më e vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, **në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, duke gjykuar të arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet ekonomike dhe financiare të OE. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme për aftësinë e OE për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në të Ligjin Nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” respektivisht nentet 6 dhe 61 të ligjit.*

*(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi).*

---

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet na AK në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila nuk eshte me e madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Për të provuar aftësinë /përshtatshmërinë profesionale të OE, AK duke analizuar rast pas rasti bazuar në parimin e proporcionalitetit në objektin e kontratës që do të prokurohet, ka gjykuar te arsyeshme përcaktimin e kësaj vlere për të krijuar besueshmërinë e nevojshme në kapacitetet profesionale të OE. Përcaktimi i vlerës së sipërcituar për furnizimet e mëparshme të ngjashme është një kriter i thjeshtësuar pranimit nga AK me qëllim nxitjen e pjesmarrjes dhe të Operatorëve të rinj në treg. Në këtë mënyrë AK krijon bindjen e përgjithshme në aftësinë profesionale të OE duke u bazuar në përvojat e mëparshme të tij realizuar në sektorin privat/publik për të marrë përsipër realizimin dhe zbatimin e objektit të kontratës që do të prokurohet.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

## Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Argumentimi si më lart. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” ” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe

*ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ne te cilin gjejmë të përcaktuar se: 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në përpjesetim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

### **2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur me Liçensë profesionale të Shoqërisë e vlefshme me kategorinë:**

- **NS-12 / A "Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit".**

**Argumentmi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me Ligjin 16/2024 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar në përputhje me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Licensave Profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", AK e sheh më se të domosdoshme që operatori ekonomik të ketë licensën e sipërpërmendur, sepse është në përputhje me pajisjet që do të blihen, montohen, në natyrën e vet objektit të kontratës objekt prokurimi si dhe ky kriter vendoset për eficientë që OE i vërteton Autoritetit Kontraktor zbatimin me sukses të Kontratës.

### **2.3.3 - 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

**Diplomën; CV-në; Dëshminë e Kualifikimit të Sigurimit Teknik; Kontratën individuale të punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave,**

Kryen punimet mekanike lidhur me instalimin e kondicionereve si kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar me *Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”*, nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. P”* i ndryshuar; VKM nr. 514, date 20.09.2017 *“Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)”*. Me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

#### **2.3.4- Operatori ekonomik duhet të ketë 3 (tre) teknikë kondicioneri;**

Operatori ekonomik, **për teknikët** e kondicionerit, duhet të paraqesë:

**-dëshmi/certifikatë formimi profesional.**

**- kontratë individuale të punës**

**- të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave**

**Argumentimi:** Vendosja e kriterit të sipërcituar për teknikët është vendosur sepse kryejn punimet lidhur me instalimin e kondicionereve dhe heqjen e kondicionerëve ekzistues për montimin e kondicionerëve të rinj janë kërkuar tre për shkak të sasisë së kondicionerëve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor si dhe faktit se do të shpërndahen për kryerjen e instalimeve në dy njësi respektivisht te Universiteti i Mjekësisë (Rektorati) dhe te Fakulteti i Shkencore Mjekësore Teknike, ky kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar me *Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”*, nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. P”* i ndryshuar; VKM nr. 514, date 20.09.2017 *“Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)”*. Me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

#### **2.3.5- Operatori ekonomik duhet të ketë 2 (dy) punonjës elektrikist**

Pë punonjësit elektrikist duhet të paraqesë:

a) **kontratë individuale e punës;**

b) **diplomën/dëshminë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore në Republikën e Shqipërisë;**

c) **të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave**

**Argumentimi:** Kryen instalimin elektrik të kondicionereve dhe heqjen e kondicionerëve ekzistues për montimin e kondicionerëve të rinj janë kërkuar dy elektrikist për shkak të sasisë së

kondicionerëve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor si dhe faktit se do të shpërndahen për kryerjen e instalimeve elektrike në dy njësi respektivisht të Universiteti i Mjekësisë (Rektorati) dhe të Fakulteti i Shkencore Mjekësore Teknike, ky kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. P”* i ndryshuar; VKM nr. 514, date 20.09.2017 *“Per miratimin e listës kombëtare te profesioneve te rishikuar (LKP)”*. Me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

**2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalente e tij, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

**2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 50001:2018/ ekuivalente e tij (Sistemi i menaxhimit të Energjisë)**

**Argumentimi:** Standardi ISO 50001:2018/ ekuivalente e tij është një standard ndërkombëtar që lejon organizatat e të gjitha madhësive të zgjedhin sistematikisht praktikat e energjisë në proceset e tyre dhe të promovojnë menaxhim më efikas të energjisë. Sistemi i Menaxhimit të Energjisë ISO 50001:2018/ ekuivalente e tij, i cili bazohet në përdorimin efikas të energjisë, është një Sistem Menaxhimi që mund të aplikohet për të gjitha llojet e ndërmarrjeve nga të vogla në të mëdha në çdo sektor dhe mund të kryhet qoftë vetëm ose të integruar me sistemet e tjera të menaxhimit. Kjo ISO bazohet në vendosjen e politikave energjetike të organizatave, menaxhimin e konsumit të energjisë në kuadrin e programeve të menaxhimit të energjisë të përcaktuara në përputhje me objektivat dhe objektivat, dhe vlerësimin e performancës së sistemit të menaxhimit të energjisë dhe ofrimin e përmirësimeve. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të energjisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë nisur nga rëndësia e objektit të prokurimit.

## **2.6 Katalogë/broshurë me të dhënat teknike për kondicionerët, ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike për artikujt e kërkuar. Në katalogë/broshurë, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme specifikimet, sipas modelit të deklaruar.**

(Katalogu duhet të ngarkohet në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimit.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40 pika 6 gërma a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur, për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën me mallin sipas specifikimeve të kërkuara në rast se shpallen fitues.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” bazuar në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik të përqëndruara për vitin 2024 dhe Shkresës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike me nr.25/53 Prot., datë 14.11.2024 me lëndë “Dërgohen Specifikimet Teknike të procedurave të prokurimit” bashkangjitur specifikimet teknike.
- Shkresës “Blerje kondicioner për Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse” me datë 01.02.2024 .
- Shkresa Nga Drejtoria e Komunikimit me nr.25/4 prot., me datë 22.01.2024 me lëndë: “Në vijim të shkresës suaj nr.25/2 prot., dt 22.01.2024”.
- Shkresa nga Drejtoria e Kurrikulave me nr.25/7 prot., me datë 12.02.2024 me lëndë: “Kthim përgjigje shkresës suaj nr.25/2, prot. dt.22.01.2024” dhe emailit për specifikimin e llojit të Kondicionerëve me datë 06.12.2024.
- Shresës me nr. 25/18 prot., me datë 19.04.2024 me lëndë: “Përcillet Vendimi nr.21, datë 18.04.2024, i Bordit të Administrimit të UMT-së”.
- Memos me nr.25/43 prot., me datë 31.07.2024 “Mbi miratimin e regjistrit të parashikimeve për procedurat e prokurimit të përqëndruara për vitin 2024” me fletën bashkangjitur

miratimi i regjistrit të parashikimeve për procedurat e prokurimit të përqëndruara për vitin 2024.

- Kontrata së ngjashme të realizuar me sukses nëpërmjet Operatorit Ekonomik dhe Autoritetit Kontraktor me nr.4223/16 prot., datë 30.12.2022;

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **Kondicioner 12 000 BTU, inverter:**

- Tipi: Mural
- Tensioni nga 200 V - 240 V.
- Temperatura e jashtme në regjim pune -15/42°Celsius.
- Niveli i zhurmave ≤ 20 DB minimum.
- Klasa e energjisë A++/A+.
- Të jetë i shoqëruar me katalogun e të dhënave teknike dhe pult komandimi në distance.
- Garancia **24 (muaj)**, nga dita e vënies në shfrytëzim.

#### **Kondicioner 18 000 BTU dhe 24000 BTU, inverter:**

- Tipi: Mural
- Tensioni nga 200 V - 240 V
- Temperatura e jashtme në regjim pune -15/42°Celsius.
- Niveli i zhurmave ≤46 DB minimum.
- Klasa e energjisë A++/A+.
- Të jetë i shoqëruar me katalogun e të dhënave teknike dhe pult komandimi në distancë.
- Garancia **24 (muaj)**, nga dita e vënies në shfrytëzim.

#### **Sasia sipas Tabelës së më poshtëme:**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Rektorati (UMT)</b>	<b>FSHMT</b>	<b>Sasia Totale</b>
1	Kondicionerë Unsplit mural 18000 BTU	Copë	2	7	9
2	Kondicionerë Unsplit mural 24000 BTU	Copë	2	0	2
3	Kondicionerë Unsplit mural 12000 BTU	Copë	2	0	2